



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme
Mbledhja nr. 30
Prishtinë, më 9 gusht 2016, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla S-I

P r o c e s v e r b a l

i mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme

Në mbledhje morën pjesë: Elmi Reçica, Teuta Rugova, Qerim Bajrami, Blerta Deliu-Kodra, Luljeta Veselaj-Gutaj, Ismet Beqiri, Puhie Demaku dhe Zafir Berisha.

Nga Zyra e Komisionit: Minire Hasani dhe Visar Krasniqi.

Pjesëmarrës të tjerë: Albulena Haxhiu, Ismajl Kurteshi, Donika Kadaj, Driton Çausi, Shaip Muja, Pal Lekaj-deputetë; Sanije Berisha, OSBE; Lumniye Murati, ZPRK; Gurjeta Zeka, LVV; Eugen Cakolli, KDI; Dren Ajeti, GLPS; Shefki Kastrati, NDI; Naim Jakaj, GP-VV; Blerta Bejtullahu, EUSK, Albert Krasniqi, KDI dhe media.

Mbledhjen e kryesoi: Elmi Reçica, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më datë 14 dhe 20 korrik 2016;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për Kufirin Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi;
4. Të ndryshme.

Kryetari i Komisionit, fillimisht iu dëshiroi mirëseardhje në mbledhje të pranishmëve, si dhe znj. Luljeta Veselaj – Gutaj, në cilësi të anëtares së re të Komisionit. Ai, në emër të Komisionit, përgëzoi sportisten Majlinda Kelmendi për fitoren në garën olimpike, për të cilën tha se meriton lëvdatë nga të gjithë, me ç'rast i ftoi të gjitha institucionet e Kosovës, që t'i bëjnë pritje dinjitoze, ngase e arritura e saj është më shumë se e të gjithëve prej nesh.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi rendin e ditës dhe shmangien nga nenet 56 dhe 64 të Rregullores, bazuar në nenin 84 të Rregullores së Kuvendit (me dy vota kundër).

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më datë 14 dhe 20 korrik 2016

Kryetari konstatoi se Komisioni i miratoi procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 14 dhe 20 korrik 2016.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për Kufirin Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi

Elmi Reçica, theksoi se çështja e demarkacionit në mes të Kosovës e Malit të Zi, e filluar para tri viteve, tani ka hyrë në një fazë të re delikate. Në kohën kur Komisioni Shtetëror për shënjimin e kufirit Kosovë-Mali i Zi, ka dorëzuar dokumentin për përfundimin e këtij procesi, e për më tepër kur Qeveria e ka marrë vendimin për të dërguar këtë projektligj në Kuvend, në opinionin e gjerë publik, politik e profesional janë shprehur shqetësimet rreth pasojave politike afatgjate, cilësisë dhe kredibilitetit profesional të këtij procesi. Republika e Kosovës, në kuadër të forcimit të subjektivitetit të vet ndërkombëtar dhe krijimit të raporteve të mira me të gjitha vendet e rajonit, në veçanti me vendet fqinjë, është duke punuar intensivisht për të përmbyllur këtë çështje, që është obligim ndërkombëtar. Duke pasur parasysh dokumentet paraprake, në bazë të të cilave është bërë pavarësia e Kosovës, së pari propozimi gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit final të Kosovës, Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës, Kushtetutën e KSA të Kosovës të vitit 1974, opinionin këshillëdhënës të GJND-së, është propozuar ky Projektligj për ratifikimin, tha z. Reçica.

Puhie Demaku, tha se i vjen keq që Qeveria, përkundër kundërshtimit që i është bërë demarkacionit, e ka proceduar këtë projektligj në Kuvend. Kërkoj që Komisioni të thirrret në ndërgjegjen e tij dhe deputetët t'i kenë parasysh tri momente të cilat tha se nuk guxojmë t'i anashkalojmë, përkundër insistimit të Qeverisë. Së pari, tha se Kuvendi e ka miratuar një rezolutë, më 25 qershor 2015, pika 4 e së cilës është shkelur nga Qeveria dhe po që se ne e kalojmë këtë projektligj, do të jemi bashkëpjesëmarrës në krimin e kësaj Qeverie.

Moment tjetër i rëndësishëm, znj. Demaku tha se është peticioni i më se 200 mijë qytetarëve, i cili kundërshton këtë demarkacion dhe këtë vijë kufitare të përcaktuar nga Komisioni Shtetëror, tepër jo-profesional. Çështje tjetër, theksoi tryezën e 3 gushtit, e cila tha se ka nxjerrë rekomandime, ku kërkohet nga Komisioni Shtetëror, që të rishikojë të gjitha dokumentet që i ka përdorur dhe të bëjë edhe njëherë rivlerësimin e gjetjeve të tyre në raport me demarkacionin, e të cilat rekomandime Komisioni duhet t'i ketë parasysh. Qëndrimi i LVV-së është që ky projektligj t'i kthehet Qeverisë dhe të mos lejojmë të bëhemi bashkëpjesëmarrës në krim.

Zafir Berisha, mes tjerash, në diskutimin e tij tha se nga e kaluara, në etapa të ndryshme të historisë, shqiptarëve gjithmonë u janë cunguar dhe tkurrur trojet e tyre dhe kjo nuk është mirë të përsëritet në këtë periudhë historike. Kosova, edhe ashtu e cunguar nga e kaluara historike, është fituar me shumë mund e sakrificë dhe nuk kemi komoditetin, si deputetë, të vëmë në pikëpyetje territorin e saj. Theksoi se tani, në mënyrë shkencore u dëshmuar qartë se Komisioni qeveritar për shënjimin e kufirit, ka bërë gabime trashanike, për të cilat ne si deputetë, nëse nuk reagojmë, pasojat e atyre gabimeve do të barten gjeneratë e gjenerata, pas nesh. Në tryezën e 3 gushtit u përmbledhën të gjitha argumentet nga qytetarët e deputetët e opozitës dhe rekomandimet nga ajo tryezë, Komisioni duhet t'i ketë në konsideratë. Tryeza e 3 gushtit e ka verifikuar falsifikimin dokumentit zyrtar, dhe

faktikisht, Komisioni qeveritar nuk e ka respektuar Rezolutën e 25 qershorit, tha z. Berisha. Demarkacioni me Malin e Zi, tha se nuk ka të bëjë asgjë me Marrëveshjen e Kumanovës, pra as me Deklaratën e Pavarësisë, e as me Pakon e Ahtisaarit, mbi të cilat dokumente, Kryeministri, me theks të veçantë, po mundohet të arsyetohet. Propozoi që Komisioni të mos ngutet, t'i ketë parasysh të gjitha zhvillimet që kanë ndodhur deri tani dhe t'i rekomandojë seancës plenare që ky projektligj, në këtë formë, të mos miratohet.

Ismet Beqiri, theksoi se kjo mbledhje e thirrur për shqyrtimin e këtij projektligji është dashur të mbahet kaherë, ndërsa ne si deputetë, të zgjedhur me votën e popullit, pas shqyrtimit të tij, votojmë ashtu siç ne e vlerësojmë. Ky projektligj, tha se është i ndjeshëm, por konsideron që konform asaj që ka ofruar baza ligjore dhe këtij rezultati që e kemi, në cilësi të anëtarit të Komisionit, do ta përkrahë projektligjin, që të procedohet në seancë plenare, për miratim.

Pal Lekaj, sa i përket procedimit të këtij projektligji, mendon se është kontrabanduar, duke cekur nenin 2 të tij, sepse çdo marrëveshje e obligon shtetin e Kosovës, që të jetë në kuadër të kornizave ligjore. Theksoi se Komisioni qeveritar, gjatë punës së tij, ka marrë për bazë kriterin kadastral, të cilin nuk e merr për bazë asnjë vend në botë dhe nuk e ka pasur parasysh kriterin gjeografik, ekonomik, etnik, historik e shumë kritere të tjera. Z. Lekaj, tha se pas ratifikimit të marrëveshjes në Kuvend, nuk mund të fillohet ndonjë negociim për ndryshimin e kufijve ekzistues. E vetmja zgjidhje për të filluar një epokë të re në këtë drejtim dhe për të qenë vetvetja shteti i Kosovës dhe deputetët e Kosovës, tha se duhet t'i themi jo kësaj marrëveshjeje dhe t'i fillojmë negociatat menjëherë me Malin e Zi, për një version me kritere çfarë janë të pranueshme ndërkombëtarisht.

Albulena Haxhiu, duke u ndërlidhur me organizimin e kësaj mbledhjeje, tha se kjo çështje është jashtëzakonisht e ndjeshme dhe është dashur të ftohet në takim Kryeministri ose ministri i MPJ-së. Ajo theksoi se pas mbajtjes së tryezës, ku u dëshmua se opozita, ekspertë e profesorë kanë pasur të drejtë, Qeveria me nguti, pa i shqyrtuar argumentet e asaj tryeze, e procedoi projektligjin në Kuvend. Në këtë takim, tha se do të duhej të ishte ftuar deputeti Bulliqi, si kontribuues në këtë çështje, e po ashtu edhe banorët e Rugovës, në cilësitë vëzhguesve. Znj. Haxhiu, tha se në këtë takim të Komisionit nuk i dëgjoi arsyet e përkrahjes së këtij projektligji, dhe se parimi kadastral nuk duhet të përdoret në asnjë mënyrë për shënimin e vijës kufitare. Aplikimi i metodës kadastrale për shënimin e kufirit, i bie që Kosova nuk është Republikë, por bashkësi e ngastrave kadastrale. Ka shumë ngastra, të cilat fare nuk janë evidentuar në kadastër.

Shaip Muja, theksoi se Projektligji për ratifikimin e Marrëveshjes për Kufirin Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi, është çështje e ndjeshme, me të cilën po sfidohen deputetët e Kuvendit dhe janë të painformuar për procedurën e shkeljeve ligjore që kanë ndodhur lidhur me këtë marrëveshje. Po ashtu, theksoi se do të mbrojë qëndrimin e tij politik, personal dhe intelektual dhe do t'i interpretojë shkeljet ligjore, të cilat kanë ndodhur në këtë marrëveshje. Shkelja e parë ligjore, tha se është bërë më 10 qershor 2015, kur Komisioni për shënjimin e kufirit i ka mbyllur definitivisht nënshkrimet e të dy komisioneve shtetërore. Shkelja ligjore tjetër, tha se është bërë më 25 qershor, kur Qeveria e Kosovës ka lejuar që ne të nxjerrim një rezolutë, duke qenë të painformuar, e në të cilën thuhet se Komisioni për shënimin e kufirit nuk guxon të nënshkruajë asgjë pa u debatuar, dhe kjo është heshtur nga Kryeministri i Kosovës. Më 12 gusht, Presidentja e Kosovës, autorizon z. Hashim Thaçin dhe ministrin e MPB-së për nënshkrim, me ç' rast ka nxjerrë një vendim joligjor, duke iu dhënë të drejtë atyre, pa e respektuar Rezolutën e 25 qershorit 2015. Më 26 gusht 2015, marrëveshja nënshkruhet nga z. Hashim Thaçi dhe më 10 shtator, Kryeministri raporton. Për punën e Komisionit Shtetëror, tha se duhet të kërkohet arbitrazh në mes të Qeverisë dhe opinionit publik. Më tej, shtoi se ish-Jugosllavia vetëm një herë ka bërë demilitim të kufirit, vizim të dytë të kufirit nuk

ka, që nga viti 1974. Sa i përket Pakos së Ahtisaarit, e cila po përdoret në këtë rast, tha se ajo nuk qëndron dhe pavarësia e Kosovës e ka trashëguar gjendjen sipas Kushtetutës së vitit 1974, me harta dhe me të gjitha. Z. Muja tha se nuk do ta votojë në këtë mënyrë këtë projektligj në seancë plenare, pa u dhënë shpjegim këtyre orientimeve të shtruara këtu.

Ismajl Kurteshi, theksoi se është i habitur nga ngutja e Komisionit, që ta shqyrtojë këtë projektligj, përderisa Qeveria ka thënë se do ta përcjellë atë në procedurë normale. Z. Kurteshi deklaroi se nuk ka njohuri se dikush ka të drejtë të falë tokë, bazuar në ligje dhe se ky projektligj nuk duhet të procedohet në seancë, përderisa nuk sqarohen disa çështje.

Sipas dokumentit të Akademisë së Shkencave të vitit 2011, në të cilin anëtar i redaksisë ishte kryeministri aktual, thuhet se linja kufitare në mes Kosovës e Malit të Zi prehet në arteriet rrugore automobilistike në Qafë, Kullë dhe në Çakorr. Kryeministri tani duhet të dalë para deputetëve dhe opinionit e të thotë cilën herë ka falsifikuar, në vitin 2011 apo po falsifikon tani. Kryeministri duhet të deklarohet se pse po e pengon rishikimin e demarkacionit, i cili ka mund të ndodhë dhe se pala malazeze nuk ka pasur asgjë kundër. Po ashtu, kryetari i Komisionit për shënjimin e kufirit, duhet t'i sqarojë opinionit se në cilin rast ka falsifikuar, në vitin 1998 kur e ka botuar hartën, ku Çakorri dhe Kulla janë pika kufitare, apo tani që po del me qëndrime të tjera. Deputetët e Kuvendit kanë nevojë për një debat në seancë, lidhur me këtë çështje, pa pjesëmarrjen e kuazi shkencëtarëve, e politikanëve e diplomatëve, tha z. Kurteshi.

Çështje tjetër, theksoi vendimin e Qeverisë, të dt. 21 mars 2012, për themelimin e Komisionit për shënjimin e kufirit, të cilit më 8 maj 2015 i vazhdohet mandati, pas 1 muaji e gjysmë që i ka skaduar ai mandat 3 vjeçar. Z. Kurteshi tha se arsyetimi se duhet bërë demarkacioni, sepse e kërkon faktori ndërkombëtar, nuk qëndron, por edhe sikur të ekzistonte, ne nuk kemi të drejtë ligjore të falim tokë me kërkesë të kujtdo qoftë. Arsyetimi se duhet kryer këtë çështje, për shkak të vizitave të rëndësishme, tha se nuk qëndron. Po ashtu, se duhet miratuar projektligji për t'u siguruar liberalizimi i vizave, tha se i ngjan arsyetimit të mbretit Zog, i cili në vitin 1925 e jep Shën Naumin e Vermoshin, sepse Mbretëria Jugosllave i kishte premtuar se qytetarët e Shqipërisë mund të dalin në Jugosllavi, pa paguar taksa, ndërsa më vonë Shqipëria është izoluar dhe Shën Naumi ka mbetur në Jugosllavi.

Çështja se kjo marrëveshje mund të ratifikohet e pastaj të ndryshohet, tha se nuk qëndron, sepse për këtë, Mali i Zi asnjëherë nuk do të pajtohet. Z. Kurteshi bëri të ditur se si rezultat i një studimit nga prof. Isufi, bazuar në koordinatat e Malit të Zi, sipas dokumentit të tyre të parë të vitit 2013, kanë qenë plus 6600 hektarë më shumë. Miratimi i këtij projektligji, tha se nuk është një vendim i zakonshëm dhe do ta votojnë vetëm ata deputetë që nuk janë të vetëdijsëm për peshën e përgjegjësisë, e cila nuk përfundon vetëm me deputetin, por do të mbeten në histori si njerëz që kanë shkelur mbi interesat e këtij vendi.

Shaip Muja, theksoi se neni 2 i projektligjit është në kolezion me nenin 11 të Marrëveshjes, dhe nëse pala malazeze do ta amendamentonte nenin 11 të Marrëveshjes, ne do të mund t'i paraqesim faktet tona.

Donika Kadaj-Bujupi, duke u ndërlidhur me diskutimet e z. Muja, tha se propozimet e tij për të diskutuar për këtë çështje në Kuvend, do të vlenin, po që se do të kishim një qeveri normale. Gabimet lidhur me demarkacionin, tha se nuk janë lëshime të Qeverisë, por janë gabime të vetëdijshme, për të cilat flet edhe dokumenti apo elaborati i vitit 2013, se deri në vitin 2013, nuk janë bërë lëshime dhe është kërkuar që të merren parasysh edhe vërejtjet e Kosovës. Në vitin 2013, diku nga fundi, pas 7-8 mbledhjeve, Komisioni ynë ka lëshuar pe dhe kanë arritur marrëveshjen, pa dhënë fare shpjegim çka ndodhi, që ndryshuan qëndrimin ndaj kërkesave të Malit të Zi. Në tryezën e 3 gushtit, të gjitha faktet e kanë konfirmuar të drejtën tonë, që kjo formë e demarkacionit të kufirit

është e gabuar, sepse nga Mali i Zi nuk është kërkuar se a posedon kadastrë për brezin kufitar, ndërsa Kosovës i është kërkuar. Tani, tha znj. Bujupi, po kërkohet përmes Kuvendit të legjitimohet një nënshkrim i cili edhe me Kodin Penal të Kosovës, cilësohet si vepër penale, tradhti ndaj vendit për faljen e territorit prej 8200 hektarëve. Me rastin e demarkacionit të kufirit në mes të Kosovës e Serbisë, znj. Kadaj-Bujupi, tha se nëse vazhdohet në këtë mënyrë, sipas parimit kadastral, humbja dhe tkurrja e territorit tonë do të jetë dyfish më e madhe. Secili deputet që mendon të votojë këtë marrëveshje, le të mendojë mirë se çfarë trashëgimie politike po lë pas vetes, tha ajo. Propozoi që projektligji t'i kthehet Qeverisë, me arsyetimin se nuk i plotëson kushtet, bazuar në argumentet që tanimë ekzistojnë.

Shaip Muja, propozoi që projektligji të mos miratohet, por të pezullohet deri në kërkimin e amendamentimit të nenit 11 të Marrëveshjes apo edhe të tërhiqet nga procedura. Ai ritheksoi se neni 2 i Projektligjit dhe neni 11 i Marrëveshjes janë në kolizion, ngase në nenin 11 të Marrëveshjes, nuk parashihet mundësia e arbitrazhit. Theksoi se mund të kërkohet edhe interpretimi i marrëveshjes dhe se nuk e përkrah këtë formë të marrëveshjes.

Driton Çausi, theksoi se bazuar në konstatimet e dhëna për projektligjin, ne do të konstatojmë se dikush nga anëtarët e Komisionit do të identifikohet si deputetë që përfaqëson institucionet dhe vepron në kundërshtim me interesat kombëtare. Secilin nga ju që vepron në dëm të interesave të popullit të Kosovës, nuk e konsideroj vëlla. Nuk kemi të bëjmë me luftë ndër populllore, por kemi të bëjmë me mbrojtjen e interesave të Republikës së Kosovës. Z. Çausi, duke u ndërlidhur me diskutimin e z. Beqirit, se duhet të veprojmë konform ndjenjës së përgjegjësisë morale, që kemi për shkak të funksionit që kryejmë, tha se nuk ka shkelje më të madhe të kësaj përgjegjësie, përderisa pas një viti argumente shkencore dhe debatit shkencor, të vazhdojmë të ngulmojmë me një vendim tepër të dëmshëm për Republikën e Kosovës. Në këtë takim, tha se mungojnë ata të cilët duhet të jenë në nivelin e përgjegjësisë, për shkak të funksioneve që kryejnë dhe për shkak të përgjegjësisë së nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje. Ai ftoi anëtarët e Komisionit, që bazuar në argumentet, të veprojnë në bazë të përgjegjësisë që duhet ta kenë, si deputetë të Republikës së Kosovës.

Në vazhdim, në mbledhje të Komisionit u hodh gaz lotsjellës.

Pas situatës së krijuar, Komisioni, në përbërje prej deputetëve: Elmi Reçica, Teuta Rugova, Qerim Bajrami, Blerta Deliu-Kodra, Luljeta Veselaj-Gutaj, Ismet Beqiri, propozuan që Projektligji për ratifikimin e Marrëveshjes për Kufirin Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi, të hidhet në votim.

Pas diskutimeve, kryetari konstatoi se Komisioni nxori këtë

P ë r f u n d i m

Miratohet Projektligji për ratifikimin e Marrëveshjes për Kufirin Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi dhe i propozohet Kuvendit, që shqyrtimi i tij të bëhet me procedurë të përshpejtuar.

Mbledhja përfundoi në orën 11:45.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Elmi Reçica